

# Udhërrëfimi i të Tjerëve drejt Jezu Krishtit

Përzgjidhni një nga situatat vijuese:

- Një i ri me të cilin jeni shok, i përket një kisha tjetër të krishterë. Një ditë gjatë drekës, ju ndieni nxitjen që të flisni me të rreth Kishës.
- Teksa ktheheni më këmbë nga shkolla në shtëpi, ju shihni një të re që po qan. E njihni atë si një anëtare të lagjes suaj, e cila nuk e ka frekuentuar ndonjë mbledhje të kishës për disa vjet. Ju ndieni nxitjen që t'i flisni asaj. Ndërkohë që përqipeni ta ngushëlloni, ajo përshkruan sfidat e veta dhe pyet: "Përse s'mund të jem thjesht e lumtur?"
- Nëna e një të riu me të cilin jeni lidhur në një faqe të medias shoqërore, ndërroi jetë kohët e fundit. Ju ndiheni të nxitur t'i përgjigjeni komentit vijues që ai bëri kohët e fundit: "Ndihem vetëm pikërisht tani. Sa do të doja që dikush të më kuptonte."

Në pjesën e pasme të kësaj flete letre apo në fletoren e klasës ose ditarin tuaj të studimit të shkrimeve të shenjta, shkruani se çfarë do të thoshit dhe do të bënit për ta udhërrëfyer këtë njeri drejt Jezu Krishtit. Në përshkrimin tuaj, përfshini përgjigjet për pyetjet vijuese:

- Cilat të vërteta të ungjillit do të ndanit për ta udhërrëfyer këtë njeri drejt Jezu Krishtit?
- Cili është një shkrim i shenjtë që ju mund ta ftonit këtë njeri ta studioje?
- Çfarë do ta ftonit të bënte këtë njeri?

